



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:065250
Datë: 26.03.2025
Numri i dokumentit: 07048704

Ac.nr.2188/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Bujar Dobërdolani - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit G. (S.) O. nga fshati K. e P., Komuna S. të cilin e përfaqëson me autorizim av. Esat Syla nga Skenderaj, kundër të paditurit F. (R.) R. nga fshati K. e P., Komuna S., të cilin e përfaqëson me autorizim av. Shefqet Ibrahimimi nga Skenderaj, për lejjim të kalimit në rrugë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.229/2021 të datës 10.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurit F. (R.) R. nga fshati Klinë e Poshtme, Komuna Skenderaj, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.229/2021, i datës 10.02.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin C.nr. 229/2021 të datës 01.02.2022, në pikën e I., të aktgjykimit ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit G.(S.) O. nga fsh. Klinë e Poshtme, Komuna Skenderaj. Në pikën II., të dispozitivit ka detyruar të paditurin F.(R.) Rr. nga fsh. K. e P., Komuna S. që ti lejoj paditësit G. O. nga fshati K. e P., kalimin e lirë dhe të pa penguar nëpër ngastrën kadastrale nr.604-3 me kulture rrugë e cila gjendet në ZK Klinë e Poshtme me gjerësinë nga hyrja prej 5.28 m dhe në gjerësinë nga dalje në rrugë kryesore prej 8.10 m, në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në pikën III., të dispozitivit ka obliguar palën e paditur që ti kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë 104 euro për hartim të padisë, 540 euro për 4 përfaqësime të avokatit, 150 euro për ekspertizë gjeodezike, gjithsej shpenzime të procedurës prej 794 euro.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit të e miratojë në tërësi si të bazuar ankesën ashtu aktgjykimi i atakuar të prishet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi G. O., përmes përfqësuesit me autorizim Esat Sylja, avokat nga Skenderaj, me datë 07.04.2021, ka ushruar padi kundër të paditurit F. R., ndërsa me parashtrësën e datës 28.09.2021 e ka bërë precizimin e kërkesepadisë ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet i padituri ti lejoj kalimin e lirë nëpër parcelën kontestuese 604-3, pasi pas nxjerrës se ekspertizës gjeodezike në mënyrë të qartë është vërtetuar se rruga kontestuese është regjistruar si parcelë e veçantë me numër 604-3. Ka theksuar se ngastra kadastrale numër 604-3 është regjistruar në emrin e të paditurit, ndërsa paraardhësit e paditësit por edhe vet paditësi e ka shfrytëzuar këtë rrugë që nga viti 1961 dhe nuk ka pasur rrugë tjetër përveç kësaj. I padituri dhe paraardhësit e tij, që nga viti 1961 nuk kanë pretenduar se kjo pronë është vetëm e tyre dhe paditësi nuk ka të drejtë të kalojë nëpër te, po edhe tash i padituri nuk ka kërkuar një gjë të tille deri në vitin 2008 i cili ka kërkuar nga baba i paditësit se në këtë rrugë nuk e ka të drejtën e kalimit duke pretenduar se është vetëm e tij, prandaj gjykatës i propozon që ta aprovojë të themeltë kërkesëpadinë e paditësit duke ia njohur të drejtën e kalimit të pacenueshëm në parcelën nr.604-3 e cila është me kulturë rrugë, kjo pasi që paditësi me shumë se 60 vite e shfrytëzon këtë rrugë dhe nga deklaratat e dëshmitareve nuk mban mend askush që paditësi apo paraardhësit e tij kanë pasur rrugë tjetër. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për hartim të padisë 104 euro, për taksën gjyqësore 20 euro për 6 përfaqësime të avokatit shumen prej 810 euro dhe për ekspertizë gjeodezike shumën prej 150 euro.

I padituri përmes përfaqësuesit me autorizim në tërësi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa qartë sepse sipas paditësit nga kërkesepadësia nuk dihet nëse kërkesa ka të bëjë me servitut apo me lejim të kalimit, nga administrimi i provave nuk konstatohet se është plotësuar kushti për krijimin e servitutit. I padituri nuk e konteston se paditësi ka kaluar në këtë rrugë edhe babi i tij, por se familja e përbashkët e të njëjtit ka pasur rrugë tjetër për të dalë në rrugën kryesore. Paditësi vet ka kërkuar këtë servitut dhe sipas ligjit respektivisht të drejtat e servitutit shumë qarte thuhet se pronari nuk mund të krijoj servitut në pronë pa pëlqimin e servitut dhënësit, njëkohësisht shumë qarte shkruhet se servituti krijohet përveç tjerash me marrëveshje dhe përfituesi i servitutit ka për detyrim të kompensojë pronarin e pronës dhe unë pa marrë parasysh se paditësi dhe babi i tij kanë kaluar në këtë rrugë, konsideroj se nuk ka asnjë element që ky servitut të fitohet në shfrytëzim me parashkrim fitues sepse nuk janë të plotësuara kushtet elementare që ky servitut të fitohet me parashkrim. I padituri i ofron marrëveshje paditësit për zgjidhje të kontestit siç është deklaruar me parë nëse paditësi është i gatshëm që të plotësojë kushtet e parapara me ligj. E kundërshtoi ekspertizën gjeodezike me arsyetim se nuk ka konstatuar se paditësi ka zgjidhje tjetër të rrugës nëpër parcelën 609 duke kërkuar plotësimin e saj. Nëse paditësi nuk është i gatshëm për marrëveshje sipas ofertës së ofruar i propozoj gjykatës refuzimin e kërkesë padisë si të pa bazuar. I kërkoj shpenzimet e procedurës për dy përfaqësime të avokatit nga 135 euro.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka administruar provat si në arsyetimin e Aktgjykimit të atakuar dhe pas vlerësimit të tyre ka vendosur si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se parcela kadastrale nr.604-3 me kulture rrugë është e regjistruar në vitin 1961 në emrin e babait të paditurit dhe tani është në emrin e të paditurit me kulture rrugë, por kontestues në mes të palëve mbetet fakti se paditësi a ka të drejtën e kalimit nëpër këtë rrugë apo ka zgjidhje tjetër për të dalë në rrugën kryesore përmes parcelave tjera që paditësi është në afërsi. Për të ndriçuar gjendjen faktike në këtë çështje juridiko civile me propozimin e palëve u nxorën provat përmes dëgjimit të dëshmitareve. Dëshmitarja, H.R. e moshës . vjeçare me vendbanim në Klinë të Poshtme, deklaroi se vjehëri i saj dhe baba i paditësit kanë qenë vëllezër dhe për me tepër se 76 vite jam martuar në Klinë të Poshtme, këtë rrugë e ka shfrytëzuar H., H.dhe Sh. si dhe S.baba i G. dhe të gjithë të tjerët sepse babai i paditëdit S.por edhe paraardhësit e tyre nuk kanë pasur tjetër rrugë. Dëshmitari Z. O. nga Klina e Poshtme i moshës ...vjeçare deklaroi se babë e babagjysh dhe tani G. nëpër këtë rrugë kanë kaluar sepse nuk kanë pasur rrugë tjetër. Kur jemi ndarë me familjen e G. mua me ka takuar prona me rrugëdalje tjetër ndërsa S. ka mbetur në truallin e vjetër dhe ka pasur rrugëdalje në këtë rrugë. Dëshmitari I.S. nga fshati Klinë e Mesme u deklarua se jam i moshës 90 vjeçare dhe ajo rruga që shkon në shtëpinë e F. ka ekzistuar dhe nëpër të ka kaluar ai vllaznillak prej që unë e mbaj në mend dhe nuk ka pasur fjalë asnjëherë për atë rrugë, H. baba i S.andej e ka pasur rrugën. Dëshmitari në pyetjen e të paditurit deklaroi se L. dhe H.e kanë pasur vetëm këtë rrugë.Dëshmitari G. S. deklaroi se kjo rrugë në mes parcelës 608-2 dhe 602-0 ka qenë e babës tim dhe e ka ndërruar me H. H. me një pronë dikund tjetër në këtë rrugë nuk ka pasur qasje as babai i F.e as baba i G. por baba im ka pasur raporte të mira me R. e Rr. dhe këtë rrugë ja ka falë babës të paditurit. Paditësi dhe familja e tij kanë pasur rrugë tjetër nëpër pronat e tyre që kanë dalë në rrugë kryesore. Dëshmitari R. R. deklaroi se me përpara aty rrugë nuk ka pasur as për neve dhe as për G. po atë rrugë e ka lëshuar G. S., në këtë rrugë ka kaluar edhe baba i G. dhe tash ky sepse nuk e kemi ndalur po kanë rrugë tjetër që mundet me dalë aty ku e ka shtëpinë ky drejt mundet me dalë në rrugë të re. Më tutje shtoj se baba i paditësit dhe G. nuk kanë pasur rrugë direkt që ka dalë në rrugë kryesore por anash të shitorja ka pasur. Dëshmitarët H. R. dhe I. S., të moshës ... dhe ... vjeçare, në raport me moshën shumë qartë dhe bindshëm shpjeguan të gjitha rrethanat lidhur me shfrytëzimin e rrugës për kohën e shfrytëzimit të saj nga paraardhësit e paditësit dhe paditësi si dhe faktet se nuk kanë pasur kontest për këtë rrugë asnjëherë. Me datë 15.11.2021, eksperti i gjeodezisë Gani Halili sipas ftesës së gjykatës, ka dalë në vend ngjarje, ndërsa me datë 18.11.2021 ka dhënë mendim me shkrim ku është konstatuar se; parcela kadastrale 604-3 ka sipërfaqe prej 269 m² është me kulture rrugë, në pjesën veriore kufizohet me rrugën lokale nr.111-0 me pronë shoqërore në gjerësi prej 8.10 m, në pjesën lindore kufizohet me ngastrën nr.601 dhe nr. 602 me gjatësi 26.29 m dhe 10.57m pronë e M. M. nga K. e P., në pjesën J. kufizohet me ngastrën nr.604-1/2 me gjatësi prej 7.34m pronë e F. R. nga K.e P. dhe nga ana perëndimore kufizohet me parcelën kadastrale nr.610-0 me sipërfaqe prej 11.22m pronë e G. O. nga Klina e Poshtme dhe ngastra kadastrale nr.608-0 me gjerësi prej 27.87m pronë e H. H. nga Klina e Poshtme. Ngastra Kadastrale nr.604-0 është evidentuar në emër të R. R. R. nga Klina e Poshtme nga viti 1961 deri

në vitin 2003 dhe sipas të dhënave kjo ngastër është ndarë në vitin 1987 dhe atë me ngastrën 604-1, 604-2 dhe 604-3 sipas kontratës së bashkëpunimit të bashkësisë familjare nr.516/1988 sipas librit të ndërrimeve 2003 jua bartë në emrin e F. R. i. Kësaj ekspertize iu është bashkangjitur fotoja nga gjeo portali shtetëror dhe skica e hartës kadastrale e vitit 1961. Sipas ekspertizës, ngastra kadastrale 604-3 është rrugë private në gjerësi minimale 5.28m dhe maksimalë prej 8.10m është në gjatësi prej 38.88m në pronësi të paditurit F. R. nga Klina e Poshtëm e cila në anën Jugore kufizohet me ngastrën nr.604-1 dhe 604-2 me një gjerësi prej 7.34m (kyçja në rrugë) pronë e paditësit ndërsa në anën perëndimorë kufizohet me ngastrën 610-0 me gjerësi prej 11.22m pronë e paditësit ku i njëjti ka vendosur dyert e oborrit në gjerësi prej 4.20m (kyçje në rrugë). Eksperti në seancën e shqyrtimit kryesor ka dhënë sqarim në ekspertizë duke konkluduar se nga provat që i ka poseduar nuk figuron se paditësi ka pasur qasje në ndonjë rrugë tjetër përveç kësaj nga viti 1961, në skicën e vitit 1961 shihet se është ndarë parcela 609 dhe është formuar parcela 610 e në mes këtyre dy parcelave ka qenë e ndërtuar shtëpia e përbashkët që gjysma e saj ka mbetur në parcelën 610 pronë e paraardhësit të paditësit dhe kjo parcelë nuk figuron se ka pasur ndonjë rrugë tjetër për dalje në rrugë kryesore përveç kësaj të tanishmes. Në rastin konkret, gjykata vlerëson se paditësi e ka fituar të drejtën e përhershme të kalimit në ngastrën kadastrale nr.604-3 me kulturë rrugë që udhëhiqet në emrin e titullarit të ligjshëm të paditurit sepse nëpër këtë pronë paraardhësit e paditësit edhe para vitit 1961, kanë kaluar të pa penguar nga askush sepse rrugë tjetër nuk është vërtetuar se kishte kjo familje. Në rastin konkret kemi të bëjmë me të drejtën e kalimit (servitutit real) që paditësi të drejtën e kalimit e ka fituar me parashkrim fitues nga se janë plotësuar kumulativisht tri kushtet e nevojshme siç janë; sendi respektivisht prona shërbyese është e paluajtshme, sendi është poseduar me mirëbesim për më tepër se 60 vjet dhe në mënyrë të pa ndërprerë. Ashtu që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që i parasheh Ligji për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore nr.827/80 i zbatueshëm për kohën e hyrjes në shfrytëzim të paluajtshmerisë lëndore si pronë shërbyese për nevojat e pronës sunduese. Kjo e drejtë është fituar me kalimin e kohës për më tepër se 20 vjet me dispozitat e nenit 54 të LMThJP ku shprehimisht është përcaktuar "Servituti real fitohet me anë të parashkrimit fitues kur pronari i pronës sunduese ka realizuar faktikisht servitutin gjatë kohës prej 20 vjetësh, kurse pronari i pronës shërbyese këtë nuk e ka kundërshtuar". Paditësi me të drejtë dhe në përputhje me dispozitat e nenit 56 par 1 të LMThJP kërkoi nga gjykata që ndaj të paditurit të përcaktohet ekzistimi i të drejtës së kalimit (servitutit) si dhe bazuar në dispozitat e nenit 57 të të njëjtit ligj, paditësi me padi kërkoi që ti ndalohej në të ardhmen pronarit të pronës shërbyese ndalimi dhe pengimi për kalim në këtë pronë në të ardhmen. Po ashtu edhe me dispozitat e nenit 86 par. të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore nr.03/L-154 shprehimisht është përcaktuar " Një kalim të domosdoshëm nëpër një paluajtshmerinë duhet të lejohet, nëse paligjshmëria fqinje nuk ka asnjë qasje tjetër në një rrugë ose nëse kjo është e lidhur me një rrugë më të gjatë dhe nëse dobia për paluajtshmerinë në favor të cilës lejohet kalimi, është më e madhe se sa dëmi për paluajtshmerinë nëpër të cilën duhet kaluar". Paditësi nuk ka rrugë tjetër alternative qoftë më të gjatë dhe të paditurit nuk i shkaktohet as një dëm sepse parcela kadastrale është rrugë dhe as i padituri nuk ka zgjidhje alternative.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në

mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkëlqje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë. Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për shkëlqjet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë.

Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit. Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, të cilat i pranon edhe Gjykata e Apelit, ngase ky vlerësim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe profesional, prandaj pretendimet ankimore të palës paditëse po ashtu edhe pretendimet ankimore të palës së paditur edhe në këtë drejtim tregohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, vlerëson si të paqëndrueshme pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata ia falë besimin dëshmitarëve që ishin të afërm me paditësin, ashtu që të njëjtat pretendime i refuzon si të pa bazuara, e kjo për faktin se nga shkesat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes në raport me objektin e kontestit, ka administruar secilën provë në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së, ndërsa i padituri, përmes përfqësusit të autorizuar gjatë të gjitha fazave të procedurës ka pasur mundësi ti sfidojë dëshmitë e dështmirëve por edhe të propozojë prova të në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 322, paragrafi 3 të LPK-së e cila dispozitë parasheh se *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Po ashtu, Gjykata e Apelit thekson se në çështjen e cila është objekt kontesti përveç dëgjimit të dëshmitarëve gjykata ka dalë edhe në vend të ngjarjes bashkë me ekspertin e gjeodezië Gani Halili, i cili ekspert me datë 18.11.2021 dha mendimin me shkrim duke kontaktuar se ngastra kadastrale numër 604-3 me sipërfaqe prej 269 m² me kulture rrugë, në pjesën veriore kufizohet me rrugën lokale nr.111-0 me pronë shoqërore në gjerësi prej 8.10 m, në pjesën lindore kufizohet me ngastrën nr.601 dhe nr. 602 me gjatësi 26.29 m dhe 10.57m pronë e M. M.nga Klina e Poshtme, në pjesën Jugore kufizohet me ngastrën nr.604-1/2 me gjatësi prej 7.34m prone e F. R. nga K. e P. dhe nga ana perëndimorë kufizohet me parcelën kadastrale nr.610-0 me sipërfaqe prej 11.22m pronë e G.O. nga Klina e Poshtme dhe ngastra kadastrale nr.608-0 me gjerësi prej 27.87m prone e H. H. nga Klina e Poshtme. Ngastra Kadastrale nr.604-0 është evidentuar në emër të R.Rr. R. nga K. e P. nga viti 1961 deri në vitin 2003 dhe sipas të dhënave kjo ngastër është ndarë në vitin 1987 dhe atë me ngastrën 604-1, 604-2 dhe 604-3 sipas kontratës së shkëputjes së bashkësisë familjare nr.516/1988 sipas librit të ndërrimeve 2003 juan bartë në emrin e F. R.. Eksperti ka ardhur në përfundim se ngastra 604-3

me kulturë rrugë private është në gjerësi minimale 5.28m dhe maksimale prej 8.10m është në gjatësi prej 38.88m në pronësi të paditurit F. R. nga Klina e Poshtëm e cila në anën Jugore kufizohet me ngastrën nr.604-1 dhe 604-2 me një gjerësi prej 7.34m (kryqja në rrugë) pronë e paditësit ndërsa në anën perëndimorë kufizohet me ngastrën 610-0 me gjerësi prej 11.22m pronë e paditësit ku i njëjti ka vendosur dyert e oborrit në gjerësi prej 4.20 m (kryqje në rrugë). Eksperti i gjeodezisë, nga të gjitha provat e administruara, në seancën e shqyrtimit kryesore ka konkluduar sipas provave të shtjelluara del se paditësi nuk ka pasur qasje në ndonjë rrugë tjetër përveç kësaj nga viti 1961. Andaj, Gjykata e Apelit e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e gjykatës së shkallës së parë ngase përmban të gjitha elementet dhe sqarimet e nevojshme për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Për sa i përket pretendimeve të palës së paditurur e cila në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes, përveç vlerësimit të kushteve për krijimin e servitutit do duhej të administront prova edhe për vlerësimin e kompensimit në emër të krijimit të servitutit, Gjykata e Apelit thekson se në rastin konkret nuk është krijuar servituti por janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që i parasheh Ligji për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore nr.827/80 i zbatueshëm për kohën e fillimit të shfrytëzimit të paluajtshmerisë si pronë shërbyese për nevojat e pronës sunduese. Kjo e drejtë është fituar me kalimin e kohës për më tepër se 20 vjet me dispozitat e nenit 54 të LMThJP ku shprehimisht është përcaktuar *"Servituti real fitohet me anë të parashkrimit fitues kur pronari i pronës sunduese ka realizuar faktikisht servitutin gjatë kohës prej 20 vjetësh, kurse pronari i pronës shërbyese këtë nuk e ka kundërshtuar"*, andaj sipas dispozitës ligjore të nenit 56 par 1 të LMThJP, ndaj të paditurit është përcaktuar ekzistimi i të drejtës së kalimit (servitutit). Në anën tjetër, i padituri përgjatë zhvillimit të procedurës para gjykatës së shkallës së parë nuk ka ushtruar kërkesë për kompensin në emër të shfrytëzimit të pronës së tij si pronë shërbyese, ndërsa gjithnjë sipas nenit 180 paragrafi 1 të LPK-së e cila decidivisht parasheh se *"në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t'i paraqesë, përkatësisht t'i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë"*, gjykata e Apelit nuk e trajton çështjen në këtë aspekt.

Gjykata e Apelit, vlerëson se në rastin konkret, në ankesë përsëriten dhe parashtrohen çështjet të cilat ishin vlerësuar para gjykatës së shkallës së parë, gjatë shqyrtimit të këtij raporti juridik kontestues, andaj lidhur me tërë këto thënie në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të mjaftuara për faktet relevante, të bazuara në ligj, të cilat i ka aprovuar edhe Gjykata e Apelit pa pasur nevojë të përsëriten.

Me rastin e shqyrtimit të ankesës, Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ankuese, mirëpo të njëjtat, nuk patën ndikim në marrjen e një vendimi ndryshe nga ky që është marrë.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:065250
Datë: 26.03.2025
Numri i dokumentit: 07048704

Ac.nr.2188/2022, me datën 25.03.2025

Kryetari i kolegjit
Ardian Ajvazi